



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 248/1 Prot.

Tiranë, më 02.02. 2026

V E N D I M

Nr. 236, Datë 02.02. 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 236 Regj., datë 16.10.2025, e paraqitur nga ankueset znj. K.H , znj. A.K dhe znj. Dh.H kundër Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri),

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës së depozituar pranë Komisionerit, ankueset K.H, A.K dhe Dh.H parashtrojnë :

“Jemi sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me statusin e nëpunësit civil gjyqësor.

Në muajin nëntor 2024, në marrjen e pagës mujore kemi evidentuar mangësi në shumën prej 10 mijë lekë të reja. I jemi drejtuar punonjësës së buxhetit lidhur me këtë, e cila në mënyrë verbale është shprehur se ka marrë mendimin verbalisht të njërit prej punonjësve të auditimit të KLGJ Tiranë, i cili i ka thënë se: Duhet të mbash pagën prej 10 mijë lekë të reja, punonjësve të cilët janë pa master (profesional apo shkencor). Kjo është pasqyruar edhe tek Memo datë 2.12.2024, e punonjësës së Sektorit të Buxhetit. Ne nuk na është thënë asnjë gjë për mbajtjen e rrogës dhe nuk na është vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni nga ana e punonjësës së Sektorit të Buxhetit në lidhje me mbajtjen e pagës tonë.

Për këtë arsye i jemi drejtuar me shkresë datë 20.11.2024, Zv/Kryetares së Deleguar dhe Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të gjykatës, lidhur me këtë mbajtje të shumës prej 10.000

lekë nga paga mujore. Në këtë moment është vënë në lëvizje Sektori i Buxhetit dhe ka kërkuar thirrjen e mbledhjes së Këshillit të Gjykatës.

U mbledh Këshilli i Gjykatës dhe në mënyrë abuzive dhe pa praninë tonë doli me vendimin nr. 36 datë 23.12.2024 ku në pikën 3 të tij ka vendosur ndër të tjera: “Zbatimin e shkresës nr. 5043 prot darë 17.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për trajtimin financiar të punonjësve për pozicionet “Sekretar gjyqësor” në përputhje me shkallën e kualifikimit sipas niveleve të diplomës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”. Punonjësja e Sektorit të Buxhetit në mënyrë abuzive ka mbajtur pagën tonë që në muajin tetor, ndërkohë që mbledhja u zhvillua në datë 23.12.2024, pra paga na është mbajtur 3 muaj para se të bëhej mbledhja. Vendimi i Këshillit të Gjykatës është i paarsyetuar dhe nuk ka asnjë gjë të qartë lidhur me mbajtjen e pagës tonë.

Ne ankueset në pozicionin e vendit të punës “Sekretare gjyqësore”, deri në muajin shtator 2024 jemi paguar njëlloj si të gjitha sekretaret gjyqësore të kësaj gjykate. Pas muajit tetor 2024, në mënyrë abuzive, na është mbajtur 10 mijë lekë të reja nga paga, me arsyetimin se nuk kemi master. Së bashku me ne, i është mbajtur kjo shumë edhe sekretares gjyqësore F.K (kjo sekretare kishte master për mësuesi)

Në gjykatën tonë kanë ardhur dy punonjës të auditit për inspektim (ata të cilët kishin udhëzuar në mënyrë verbale punonjësen tonë të buxhetit, që punonjësit që janë pa master t’u mbahet paga 10.000 lekë të reja). Ishin këta punonjës të auditit të cilët urdhëruan përsëri në mënyrë verbale punonjësen e buxhetit që sekretares gjyqësore F.K ti kthehej 10 mijë lekëshi dhe shuma e mbajtur deri në ato momente. (kjo punonjëse ka master për mësuesi dhe jo për drejtësi gjë për të cilën ju mbajt paga). Pra, i bie që ti të jesh juriste me bachelor por mund të kesh çdo lloj masteri dhe të njihet kategoria, mund të kesh dhe master për infermieri, mësuesi, a ku dimë ne.

Dhe, menjëherë në datë 2.4.2025, është mbledhur Këshilli i Gjykatës dhe ka vendosur: “Miratimin dhe kthimin në kategorinë e mëparshme të pagës së sekretares gjyqësore F.K , konkretisht IV-I dhe kthimin e diferencave të pagave që i janë mbajtur nga muaji tetor 2024, deri më sot”. Kjo punonjëse u tërhoq edhe nga gjykimi i padisë, pasi ju njoh masteri që kishte për mësuesi.

Shkresa e KLGJ nr. 5043, datë 17.10.2024, është thjesht një udhëzim dhe pasqyrohet qartë se kjo shkresë bën fjalë për rekrutimin e punonjësve që do të vijnë në pozicionin respektiv mbas krijimit të Hartës Gjyqësore në Gjykatat e Republikës së Shqipërisë sipas nivelit të gjykatave dhe pozicionit të punës.

Me krijimin e Hartës Gjyqësore të RSH, është përcaktuar qartë niveli i Gjykatës dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat është gjykatë e Nivelit të Dytë dhe si rezultat i nivelit të gjykatës, është bërë dhe rritja e pagës dhe kemi kualifikimin si rezultat i nivelit të gjykatës, dhe jo nivelit të masterit të diplomës, pasi asnjëherë nuk kemi marrë shtesën e kualifikimit të masterit pasi nuk e kemi atë. Ligji nuk mund të ketë fuqi prapavepruese, por edhe nëse ligji ka fuqi prapavepruese nuk mund të na rëndojë ne, pasi jemi punonjëse prej 20 vjetësh në këtë gjykatë

dhe me statusin e nëpunësit civil gjyqësor. Shkresa e KLGJ flet qartë dhe pastër për rekrutimin e punonjësve të rinj pas krijimit të Hartës Gjyqësore.

Për sa më sipër, ne i jemi drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë me kërkesë padi dhe në datë 6.10.2025 Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë pranoi padinë tonë. (për momentin nuk e kemi vendimin gjyqësor pasi nuk është zbardhur)

Ne i jemi drejtuar institucionit tuaj për këto arsye:

- 1. Jemi diskriminuar që nga momenti i mbajtjes së pagës në mënyrë të menjëhershme në muajin tetor 2024, pa asnjë shpjegim dhe në kundërshtim me ligjin dhe Statusin e Nëpunësit Civil Gjyqësor, duke na shkaktuar dëm shëndetësor, moral, ekonomik dhe stres, duke na shqetësuar jo vetëm ne, por dhe familjarët tanë.*
- 2. Nuk ka reaguar drejtuesi i gjykatës tonë në lidhje me mbajtjen e pagës, por vetëm kur ne kemi kërkuar informacion lidhur me këtë mbajtje, atëherë është vënë në lëvizje Këshilli i Gjykatës. Megjithatë në mënyrë verbale kemi kërkuar për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës për të dhënë shpjegime mbi pretendimet tona lidhur me mbajtjen në mënyrë të gabuar, nuk na kanë thirrur, por kanë thirrur vetëm punonjësen e Sektorit të Buxhetit, përsëri duke na diskriminuar, fyer dhe shqetësuar, si nga ana mendore dhe ajo shëndetësore.*
- 3. Kur kemi hapur procesin gjyqësor dhe na ka ardhur data e gjykimit, kemi kërkuar leje për të marrë pjesë në gjykim duke ju treguar fletë-thirrjen eprorëve tanë se ishim thirrur për t'u dëgjuar, por nuk na kanë dhënë leje duke na diskriminuar, nënvleftësuar dhe stresuar. Dihet se kur të thërret gjykata, në respekt të ligjit dhe institucionit kishin detyrimin ligjor për të na lejuar. Veç kësaj, institucioni jonë ishte palë e paditur dhe asnjëherë në asnjë seancë nuk u paraqit, ndaj jemi detyruar të bëjmë kërkesë me shkrim dhe të protokolluar për tu lejuar të marrim pjesë në gjykim, gjë që na ka shkaktuar irritim, ankth dhe stres. Dhe sa herë që kemi kërkuar leje për të marrë pjesë në gjykim, gjithmonë jemi ndjerë të frikësuar, të poshtëruar, të stresuar, madje dhe me probleme të shëndetit, pasi kërkesën tonë për të marrë pjesë në gjykim nuk e kanë pritur asnjëherë mirë.*
- 4. Në mënyrë verbale diskutohej në institucionin tonë se “ne kudo që të shkonim në të gjitha shkallët e gjyqësorit nuk kishim për të fituar gjyqin” dhe kjo na e bënte edhe më të vështirë punën në përditshmërinë tonë duke ulur aftësinë si në punë edhe në familje, duke sjellë pasoja të shëndetit, duke u sforcuar në mënyrë që ta kryenim punën të qeta dhe me efektivitet.*
- 5. Jemi ndjerë të diskriminuara, pasi kemi kryer të njëjtën punë si koleget tona sekretare gjyqësore me të njëjtën ngarkesë, por duke u pasuar si specialiste.*
- 6. Ky diskriminim ka reflektuar edhe në marrëdhëniet familjare, pasi ne jemi nëna që mbajmë një peshë të madhe si në punë dhe në familje.”*

Përfundimisht ankueset kërkojnë nga Komisioneri që të konstatohet diskriminimi dhe të ndalohet diskriminimi ndaj tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës nr. 239, datë 14.11.2024, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1442/2 prot, datë 11.11.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr. 2280/1 prot., datë 20.11.2025, ka kthyer përgjigje Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, duke parashtruar:

Me shkresën nr. 5043, datë 17.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor jemi njoftuar mbi disa mospërputhje të nivelit të diplomës të vendosur në kriteret minimale të rekrutimit me atë të vendosur për trajtimin financiar, për pozicionet e punës K/Sekretar, Përgjegjës Sektori, Sekretar Gjyqësor dhe Specialist.

Bazuar në VKM nr. 325, datë 31.5.2023, i ndryshuar me VKM nr. 421 datë 26.6.2024, janë përcaktuar kategoritë, klasat e pagës (pozicionet e punës për secilën kategori) paga për pozicion dhe shtesa e nivelit të kualifikimit. Për kategorinë ekzekutive (specialist/sekretar gjyqësor) klasa IV-1, IV-2, IV-3, ku janë përcaktuar kategoritë për çdo pozicion, klasa e pagës dhe grupi i diplomës (lidhja nr. 1 dhe 7/1). Për kategorinë ekzekutive ku përfshihen specialist dhe sekretar gjyqësor përcaktohet klasa e pagës IV-1, grupi i diplomës 1 ose 2 “*Master profesional ose shkencor*”.

KLGG me vendimin nr. 444, datë 24.7.2024 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore” ka përcaktuar kategoritë për çdo pozicion pune, klasën e pagës dhe grupin e diplomës për kategorinë e ulët drejtuese dhe kategorinë ekzistuese.

Të trija sekretaret kanë ardhur në dijeni verbalisht nga shefe e sektorit të buxhetit, në lidhje me shkresën e ardhur nga KLGG dhe për mënyrën e pagesës së tyre në bazë të nivelit të diplomës dhe e kanë kundërshtuar.

Në zbatim të shkresës së KLGG, Zv/Kryetarja e Gjykatës, i ka dërguar shkresë Sektorit të Buxhetit dhe Financës së Gjykatës midis të tjerash urdhëron dhe zbatimin e shkresës së ardhur nga KLGG në lidhje me pagesën e sekretares gjyqësore sipas lidhjes nr. 1 dhe lidhjes nr. 7/1 në përputhje me nivelin e diplomës.

Sekretaret gjyqësore A.K , K.H , F.K dhe Dh.H , nuk kanë qenë dakord me ndalesën që do t’ju bëhej për shkak të nivelit të diplomës. Në datën 20.11.2024 sekretaret gjyqësore kanë paraqitur kërkesë Zv/Kryetares së Gjykatës duke kërkuar shkakun e mbajtjes së shumës prej 10.000 lekë në pagën e muajit tetor 2024.

Me shkresën e datës 2.12.2024, Shefe e Sektorit të Buxhetit, i kthen përgjigje Zv/Kryetares së Gjykatës dhe për dijeni sekretareve gjyqësore, në lidhje me ndalesën e kryer nga ana e degës së financës, duke arsyetuar se ndalesa në pagë është bërë për shkak se sekretaret janë me diplomë të nivelit “*Bachelor*” dhe janë trajtuar në listë pagesën e muajit tetor 2024, me pagën e klasës IV-2, sipas VKM 325/2023 i ndryshuar me VKM nr. 421/2024.

Vendimi KLGJ 444/2023, ka përcaktuar që pozicioni “*sekretar gjyqësor*” me kategorinë në klasën IV-1, duhet të ketë diplomë të nivelit master (Grupi 1 ose 2) dhe nuk ka përcaktuar kategorinë e pagës për pozicionin sekretar gjyqësor me diplomë të nivelit *bachelor*. Duke iu referuar vendimit të KLGJ nr. 444/2023 dhe VKM 325/2023 i ndryshuar, lidhjes 1, është përcaktuar që niveli i diplomës *bachelor* (grupi 3) i korrespondon klasës IV-2.

Në këto kushte shefe sektorit të buxhetit me “memo” dt. 2. 12.2024 i ka kërkuar Këshillit të Gjykatës të bëjë rregullimet ku përcaktohet niveli i pagave sipas VKM 325/2023 i ndryshuar.

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. 36 datë 23.12.2024, ka vendosur zbatimin e shkresës nr. 5043 dt. 17. 10.2024 të KLGJ, për pozicionin Sekretar gjyqësor, në përputhje me shkallën e kualifikimit sipas nivelit të diplomës.

Me vendimin e Këshillit të Gjykatës sekretaret gjyqësore nuk kanë qenë dakord dhe e kanë kundërshtuar duke paraqitur kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Me vendimin datë 6.10.2025 Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin e padisë, vendim i cili nuk është paraqitur nga paditëset. Çdo nëpunës civil gjyqësor ka të drejtën e ankimit të vendimeve të Këshillit të Gjykatës për të rifituar ose jo të drejtën e cenuar.

Për sekretaren gjyqësore F.K pas verifikimit të dokumentacionit në dosjen e saj personale u konstatua se e kishte diplomën “Master” dhe me vendim të Këshillit të Gjykatës nr. 22, datë 2.4.2025, është vendosur kthimi në kategorinë e mëparshme si dhe kthimin e diferencave të pagave të mbajtura.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka zbatuar vendimin e KLGJ nr. 344/2023, VKM nr. 325/2023 i ndryshuar me 421/2024, si dhe shkresën e KLGJ nr. 5043 datë 17.10.2024 në lidhje me nivelin e diplomës dhe nuk ka kryer diskriminim në lidhje me arsimin për tre sekretaret gjyqësore.

Nga ky vendim i Këshillit të Gjykatës për tre sekretaret gjyqësore që janë nëpunëse civile gjyqësore të konfirmuara me status mendojmë se ka sjellë reflektim vetëm në gjendjen ekonomike të familjeve të tyre. Nuk ka pasur asnjë lloj diskriminimi në kryerjen e detyrave nga ana e sekretareve gjyqësore pasi kanë qenë dhe janë aktualisht në pozicionet e tyre funksionale, duke

kryer detyrat më së miri dhe me përkushtim, pasi janë sekretare të nderuara, të respektuara dhe me vjetërsinë më të madhe në gjykatë.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga sekretaret gjyqësore se janë ndjerë të diskriminuara pasi nuk janë lejuar nga institucioni për tu paraqitur në seancat gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, sqarojmë se ky pretendim nuk qëndron, se puna në gjykatë nuk mund të pezullohet duke shkuar të treja sekretaret në procesin gjyqësor për shkak të organikës me sekretare dhe të detyrave që ato kryejnë. Kjo situatë mund të zgjidhesh me një përfaqësues ligjor me prokurë ose dy sekretaret që ishin paditëse në gjykim kishin të drejtën me deklaram në seancë gjyqësore për ti përfaqësuar një prej tyre në gjykim, pasi pretendimet e tyre ishin të njëjta.

Sekretaret gjyqësore gjatë vitit 2024 kanë zhvilluar edhe gjykime të tjera në Gjykatën Administrative Tiranë dhe janë lejuar të shkojnë vetë ose me përfaqësuesit e tyre ligjorë pa sjellë pengesë në zhvillimin e gjykimeve dhe të detyrave që ato kryejnë këtu në Gjykatë. Nuk mund të pezullohet puna për të shkuar të gjitha sekretaret në proceset e tyre gjyqësore, siç është edhe rasti i ankuesëve, pasi gjykimet duhet të zhvillohen, shërbimi dhe aksesit për publikun në Gjykatë duhet të vazhdojë normalisht. Nuk mund të paraqiten kërkesa që duam të shkojmë të treja në gjyq, pasi sekretaret gjyqësore kanë njohuri juridike dhe mund ti përfaqësojë një e vetme dhe koleget. Ish kancelari nuk i ka lejuar vetëm në një seancë për të shkuar për shkak të mungesës me sekretare gjyqësore, ngarkesës në punë me gjykime dhe regjistrimin e çështjeve në sistemin ICMIC, mungesës me sekretare gjyqësore, ndërsa në seancat e tjera të treja sekretaret janë lejuar dhe paraqitur në gjykimin e çështjes së tyre.

Në këto kushte Gjykata Berat, ka zbatuar aktet ligjore sipas hierarkisë së tyre, nuk ka bërë ndonjë veprim me dashje apo diskriminim në punëmarrësve të saj në lidhje me arsimin ose çdo shkak tjetër, apo të favorizojë disa punonjës në dëm të punonjësve të tjerë. Të gjithë punonjësit civilë gjyqësor dhe punonjësit e tjerë mbështetës të Gjykatës janë trajtuar dhe trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Në këto kushte nuk kemi shkelur asnjë nga dispozitat e ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, i ndryshuar dhe kërkojmë nga Komisioneri të mos konstatohet diskriminim për ankueset A.K , K.H dhe Dh.H , për shkak të arsimit apo për çdo shkak tjetër.

3. Me shkresën nr. 6080/1 prot datë 21.11.2025 ka kthyer përgjigje Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke parashtruar ndër të tjera se:

Rezulton e provuar se ankueset ushtrojnë detyrën si sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Me vendimin nr.3 6 datë 23.12.2024 Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat vendosi zbatimin e shkresës nr. 5043 prot datë 17.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për trajtimin financiar të punonjësve për pozicionet sekretar gjyqësor në përputhje me shkallën e kualifikimit sipas nivelit të diplomës.

Duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e Këshillit të Gjykatës ankueset i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë padi me objekt : *“1. Shfuqizimin e vendimit nr. 36 datë 23.12.2024 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. 2. Kthimin e shumave të mbajtura. 3. Shpenzimet gjyqësore ti ngarkohen palëve të paditura.”*

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata Administrative e Apelit vendosi, pranimin e kërkesë padisë, vendimi i arsyetuar ende nuk na është komunikuar.

Gjatë gjykimit të çështjes gjyqësore KLGJ nëpërmjet prapësimeve të depozituara me shkrim, por edhe përgjatë seancave ka mbajtur qëndrimin duke argumentuar si vijon:

Ligji nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, objekt i të cilit është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e sistemit të gjykatave në Republikën e Shqipërisë, kompetencat dhe madhësitë e gjykatave, organizimin e brendshëm të gjykatave, funksionimin e administratës së gjykatës, statusin e nëpunësve civilë gjyqësor, ligj i cili zbatohet për çdo gjykatë me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatë të posaçme të krijuar me ligj, në nenin 56 parashikohet: *“...Për pozicionin e sekretarit gjyqësor, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta: a) të jenë diplomuar në drejtësi; b) të kenë përvojë prej të paktën një viti të njohur si praktikë profesionale ose çdolloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën....”*, sipas kësaj dispozite kandidati për sekretar gjyqësor duhet të jetë i diplomuar në drejtësi, por pa përcaktuar nivelin e diplomës.

Në nenin 64, pika 4, parashikon se: *“Këshilli i Ministrave miraton me vendim : a) rregulla mbi strukturën dhe rritjen e pagave për nëpunësit civilë gjyqësor, përmes së cilës, skema e pagës duhet të jetë së paku e njëjtë me atë të kategorive përkatëse të nëpunësit civil; b) rregullat mbi kohëzgjatjen e punës, ditët e pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës”*.

Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 325 datë 31.5.2023 *“Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesat e tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”*, konkretisht në lidhjen 1, janë përcaktuar kategoritë, klasa e pagës (pozicioni i punës për secilën kategori), paga për pozicion, shtesa për nivelin e kualifikimit dhe shtesa për vjetërsi. Për kategorinë ekzekutive ku përfshihet edhe sekretar gjyqësor, specialist, klasa IV-1, IV-2, IV-3 dhe IV-4, ku për çdo klasë korrespondon para për pozicion dhe shtesa e nivelit të diplomimit të përcaktuara në lidhjen 7 dhe 7/1.

Rezulton se ka një mospërputhje të nivelit të diplomës të vendosur në kriteret minimale të rekrutimit, i cili është të jetë diplomuar në drejtësi me nivelin e diplomës së vendosur për trajtimin financiar për pozicionin sekretar gjyqësor.

VKM nr. 325 datë 31.5.2023, konkretisht në lidhjen 1, janë përcaktuar kategoritë, klasa e pagës (pozicioni i punës për secilën kategori), paga për pozicion, shtesa për nivelin e kualifikimit dhe shtesa për vjetërsi. Ndërsa në lidhjen 7 dhe 7/1, klasa e pagave të pozicioneve të punës të

nëpunësve civil gjyqësor në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë ku përfshihet edhe sekretar gjyqësor, klasa IV-1 e pagës për pozicion dhe shtesa e nivelit të diplomimit 1 ose 2 master profesional ose shkencor. Në kushtet kur në vendimin nr. 444 datë 24.7.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk përcaktohet pagesa për pozicionin sekretar gjyqësor me nivelin *bachelor*, për rrjedhojë duke ju referuar VKM nr. 325 datë 31.5.2023 lidhjes 7/1, kategoria ekzekutive (klasa IV-1) ku përfshihet pozicioni sekretar gjyqësor, në të cilin trajtohet paga për pozicion sipas nivelit të kualifikimit të diplomës dhe konkretisht niveli i diplomës master 1 ose 2 i korrespondon klasës IV-1 dhe niveli i diplomës grupi i 3 *bachelor* i korrespondon klasës IV-2. Në përfundim KLGJ ka kërkuar rrëzimin e padisë.

Pretendimi i ngritur në ankesën drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga ankueset.

Sipas ankesës nr. 236 regj, datë 16.10.2025, rezulton se shkak për të cilin pretendohet diskriminimi është për shkak të gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër i cili parashikohet nga neni 1, të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar për arsye si më poshtë do të argumentohet:

Së pari, termi “*Diskriminim*” në kuptim të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010: Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Së dyti, Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) në KLGJ ka realizuar auditim dhe nga testimet e kryera në lidhje me përputhjen e pagave sipas pozicionit të punës, kategorinë e pagës dhe grupit të diplomës është konstatuar mospërputhje e nivelit të diplomës të vendosur për kriterin minimal të rekrutimit me atë të vendosur për trajtim financiar për pozicionin e punës sekretar gjyqësor në Gjykata, është konstatuar se për periudhën nga 1.4.2023 e në vijim, me hyrjen në fuqi të VKM nr. 325/2023 janë aplikuar pagat për nëpunësit civil gjyqësor sipas lidhjes 7/1, rezulton se janë trajtuar me kategorinë e pagës IV-1, të gjithë sekretarët gjyqësor dhe specialistët pavarësisht nivelit të diplomës që zotërojnë.

Përcaktimi i pagës i njëjtë pavarësisht nivelit të diplomës për pozicionin sekretar gjyqësor është i gabuar, pasi në lidhjen 7/1 të VKM nr. 325/2023 dhe lidhja nr. 2 vendimi nr. 444, datë 27.7.2023, i KLGJ nuk ekziston përcaktim me nivel diplome *bachelor*, përcaktohet se për pozicionet sekretar gjyqësor dhe specialist kategoria e pagës IV-1 kriteri minimal i diplomës për efekt pranimi në pozicionin përkatës të punës është niveli i diplomës 1 ose 2, përcaktim ky i cili bie ndesh me vendimin nr. 148 datë 29.3.2023 të KLGJ, kreu XII “Kritere të veçanta” për kriteret e nivelit të arsimit për këtë pozicion duke përcaktuar nivelin minimal të arsimit *bachelor*.

Sa më lart, vlerësojmë se nuk plotësohet asnjë nga kushtet për të qenë para diskriminimit, pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë. Gjykata si

dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë respektuar VKM nr. 325/2023, e cila është e qartë dhe përcakton pozicionin, klasën e pagës si dhe grupin e diplomës që i korrespondon.

Nga auditimi i ushtruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është konstatuar mospërputhje e nivelit të diplomës të vendosur për kriterin minimal të rekrutimit me atë të vendosur për trajtimin financiar për sekretar gjyqësor, duke qenë përpara këtij fakti, KLGJ ka përcjellë edhe pranë Gjykatës Berat, me anë të shkresës nr. 5043, datë 17.10.2024 këtë konstatim.

Për më tepër, referuar VKM në fjalë, paga mujore për pozicionet e punës kryesekretar, përgjegjës sektori, sekretar gjyqësor/specialist do të jetë sipas lidhjes nr. 1 ku janë të përcaktuara drejtë kategoritë, klasat e pagës për çdo pozicion pune, paga për pozicion dhe shtesa e nivelit të kualifikimit dhe në lidhjen nr.7 dhe 7/1 përcaktohet kategoria për çdo pozicion pune, klasa pagës dhe grupi i diplomës. Kështu për kategorinë ekzekutive përcaktohet klasa e pagës IV-1, grupi i diplomës 1 ose 2, i korrespondon klasës IV-1 dhe niveli i diplomës grupi 3 *bachelor*, i korrespondon klasës IV-2.

Është e qartë se në asnjë moment dhe asnjë veprim nga ana e KLGJ të ketë qenë diskriminues, pasi në çdo rast ka zbatuar vetëm VKM nr. 325/2023 së cilës i referohet paga. Gjetjet e konstatuara i janë komunikuar edhe Gjykatës ku ushtrojnë funksionet ankueset, pra nuk ka asnjë moment dallimi apo diferencimi të tyre në kuptim të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010.

4. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, me shkresën nr. 1826, prot datë 29.12.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seancë dëgjimore publike në datën 15.01.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të përfshira në procedurën administrative, ankueset K.H, Dh.H dhe A.K, të cilat u paraqitën personalisht, KLGJ, përfaqësuar nga z.I.Ll, sipas autorizimit nr. 6785/1 prot., datë 09.01.2026, lëshuar nga Kryetari i KLGJ z. I. R dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, përfaqësuar nga znj. E. Sh, me detyrë Kancelar e Komanduar, sipas autorizimit nr. 90, datë 14.01.2026, lëshuar nga Zv.Kryetari i Gjykatës z. I.H.

Gjatë seancës dëgjimore dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, palëve iu relatua mundësia e zgjidhjes së çështjes me pajtim.

Përfaqësuesja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, deklaroi se, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, ishte administruar pranë Gjykatës në datën

14.01.2026, pra vetëm një ditë para datës së seancës dëgjimore pranë Komisionerit dhe në këto kushte kërkoi kohë që të njiheshin me vendimin dhe të diskutohej me titullarin e institucionit mbi mundësinë e pajtimit midis palëve.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, në datën 23.01.2026 (nr.202 prot) pranë Komisionerit u administrua marrëveshja për zgjidhjen e çështjes me pajtim, me nr.175 prot., datë 22.01.2021, e nënshkruar midis ankueseve Dh.H , A.K dhe K.H dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, përfaqësuar nga Zv/Kryetari z. I.H. Referuar kësaj marrëveshje, rezulton se palët kanë arritur një marrëveshje për ta zgjidhur çështjen si më poshtë:

1. *Subjektet ankuese K.H , znj. A.K dhe znj. Dh.H heqin dorë nga ankimi i paraqitur pranë komisionerit, pasi nuk konstatohet diskriminim nga ana e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për rastin tonë.*
2. *Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat merr përsipër zbatimin e vendimit nr. 99, datë 06.10.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit për shfuqizimin e vendimit nr. 36 datë 23.12.2024 të Këshillit të Gjykatës. Pagimin e shumave të ndaluara në pagën për pozicionin sipas VKM 325/2023 të ndryshuar me VKM nr. 421/2024. Korrigjimin e listpagesave në degën e tatimeve.*

Në këto kushte dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, në kushtet kur palët kanë arritur në një marrëveshje midis tyre për zgjidhjen e çështjes objekt i ankesës objekt shqyrtimi, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

6. Me e-mailin e datës 29.01.2026, ankueset kanë paraqitur një kërkesë për heqje dorë nga ankesa kundrejt Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi çështja është zgjidhur me marrëveshje dhe kërkojnë nga Komisioneri pushimin e ankimit.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës

*apo braktisja e procedurës”, pika 1, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon:
“1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron
përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e
tërheq atë.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankueset në marrëveshjen për zgjidhjen e çështjes me pajtim, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 236 regj, datë 16.10.2025, paraqitur nga ankueset K.H , A.K dhe Dh.H kundër Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) dhe pika 3, nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 236 Regj., datë 16.10.2025, të paraqitur nga ankueset A.K , K.H dhe Dh.H kundër Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore dhe pala ankuese është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja arsimore, çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti